

VENDIM
Nr. 99, datë 13.9.2013

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC-LANABREGAS” SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, në mbledhjen e tij të datës 13.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a., për ndryshimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec-Lanabregas” sh.a., dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës me nr. 145, seria PV11SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve me nr. 134, datë 6.12.2011 në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe licencës me nr. 147, seria TPV11SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 6.12.2011 në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hec-Lanabregas” sh.a.

2. Mbajtës i licencave të mësipërme do të jetë shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo